Arben Ademi

NËPËR STINË

Poezi

THROUGH THE SEASONS

Poems

KLUBI LETRAR
"DE RADA" FERIZAJ

Arben Ademi
NËPËR STINË
Poezi
THROUGH THE SEASONS
Poems
Translated by Fadil Bajraj

©Arben Ademi
©Klubi Letrar "De Rada"

Redaktorë:
Xhevdet BAJRAJ
Zyrafete SHALA

Recensentë:
Arsim HAMITI
Gazmend BYTYÇI

Kopertina:
Drian Shala
Jeta Rexhepi

Shtypi:
Shtypshkronja
InterGraf-Ferizaj

ARBEN ADEMI

NËPËR STINË

Poezi

THROUGH THE SEASONS

Poems

Translated by Fadil Bajraj

Ferizaj, 2022

Nënës sime dhe motrës Adifetes, që do të rrojnë me mua gjithmonë!

To my Mother and my sister Adifete, who will always live with me!

E PAZAKONTË

Është kaq e pazakontë
Në një ditë si kjo
Pluhuri të bëhet mjegull
Dhe Dielli të buzëqesh
Kaq lirshëm

Është dimër

SO UNUSUAL

It's so unusual
On a day like this
Dust becomes mist
And the Sun smiles at you
So freely

It is winter

PRAG VDEKJEJE

Dhe shtegtarët
Mësyjnë vendlindjen
Vjeshta çirret
Shkatërron foletë
Dimri gjëmon
në prag vdekjeje

Është kaq e pazakontë

THE BRINK OF DEATH

And migrants
Are heading for their homeland
Autumn screams
Destroys nests
Winter roars
On the brink of death

It's so unusual

MJEGULL

Ç'janë këta njerëz
Të murëzuar
Statuja të heshtura
Kam frikë të jetë mallkim
Që s`lahet dot me shekuj

Ndjej sikur po plakem
Mezi ec në mjegull
Po ik në kohën time
S`dua të plakem në shekuj

FOG

What are these people
Walled up
Silent statues
I'm afraid it's a curse
Which cannot be washed for centuries

I feel like I'm getting old
I can barely walk in the fog
I disappear in my time
I will not age in centuries

I ÇMENDUR

I.

Përçapesha gjurmëve tua
Që borës ia falje
Çdo mëngjes
Dhe i shkrija shputat e tua
Akull
Para se Dielli të zgjohej
Sërish ...

II.

Kurrë s`më shihje
As netëve kur pothuajse
Shtangohesha
Me lotin kokërrzuar
Fijeve të qerpikut

III.

Ti ktheheshe
Dhe kaloje pranë meje
Statujë
Gjysmë i vdekur
Prisja një buzëqeshje
Që se morra kurrë

IV.

Dhe një natë
Putha shputën tënde
I thashë:
"Të dua sa Diellin"
Buzët më ngrinë pastaj
Por shputa i tha shputës
Dhe kështu gjurmë pas gjurme
Fjalët erdhën tek Ti !!!

V.

E pashë kur e fike dritën
E ndjeva borën të kërciste
Ishin hapa gjysmëzbathur
Dhe një dorë që dridhej
Mbi ballin flakë
Dëgjova "Pse-në" tënde
Ndërsa po çmendesha
Në agoni
Dhe s`mbeta më për askënd
As për Ty

CRAZY

I.

I was exerting my efforts through your tracks
Which you gave to the snow
Every morning
And I melted your icy
Feet
Before the Sun rose
Again...

II.

You never saw me
Not even on nights when almost
I was stunned
With a grainy tear
On the eyelashes

III.

You were coming back
And passing me by
Like a statue
Half dead
I expected a smile
Which I never got

IV.

And one night
I kissed your sole
And I said:
"I love you as much as the Sun"
Then my lips froze
But the sole told the sole
And so trace after trace
The words came to You!!!

V.

I saw when you turned off the light
I felt the snow crunch
They were half-barefoot steps
And a trembling hand
On the burning forehead
I heard your "Why?"
While I was going crazy
In agony
And I was no good for anyone else
Not even for You

MALLKIM

Mallkuar qofsh Mal
Që aq shumë të desha
Sot e lash kasollen
Mes shtyllave të dritës
Dhe ecja mërmërit
Vertebrave tua
Gurët rrokullisen pas meje
Të "çmendur"
Po zbres
Po ik...
Dhe rrëpirat tua gjakosen
S'do kthehem më kurrë

Po ik ...
Me mallin e Zanës
Që ma fshehe
Përrenjve të harruar
Terreve tua
Zërin e saj që e bartje
Gurinë pas gurine
Dhe aq shumë të pëlqente
Gjaku
Loti

Njëqind herë thirra krushqit
Njëqind herë s`gjetën nusen
Këngën në vaj ma ktheve
S`pat dasmë për mua
Sot mblodha valixhet
Sot të njoha Ty
Mezi frymoj nga plagët
Shkret mbetsh i mallkuar
Shkret

CURSE

Damned you Mountain
Because I loved you so much
I left the cabin today
Between the pillars of light
And I walked mumbling
Through your vertebrae
The stones are rolling behind me
Gone "crazy"
I'm going down
I'm leaving...
And your slopes are bloody
I will never come back

I am going away...
With the Fairy's longing
Which you hid from me
By the forgotten streams
Through your darkness
Her voice that you carried
From rocky ground to rocky ground
And you liked it so much
Blood
Tear

I have invited wedding guests a hundred times
A hundred times they did not find the bride
You turned my song into a cry
There was no wedding for me
Today I packed my bags
Today I met You
I can hardly breathe from the wounds
May you be abandoned forever
Abandoned forever

PËRKUNDEM

Dhimbjet aterojnë
Rrugëve të errëta
Lakuriqë të natës
Mbushur gjinjtë plot
Dromca errësire
Prapa tyre bien
Klithje të trishtueshme
Drapër
Hënë e gjorë

Taxi-të janë të fjetur
Dhimbjet të çmendura sot
S`di në janë këto rrugë
Që shpesh i rrugëtova
Apo kështu ngjan fundi
Se vdekjen se njoh dot

I'M ROCKING

The pain lands
On the dark streets
Bats
With breasts full
Of pieces of darkness
Fall behind them
Sad cries
Sickle
Poor moon

Taxis are sleeping
Crazy pains today
I don't know if these are the roads
Through which often traveled
Or at least that's how it ends
Because I don't know death anyway

VALLE DHIMBJEJE

Dhe do të doja
Shpirtin të ma bartnin
Dallgët e detit
Në muzgun e skuqur
Në verën e vonë
Në ujin e akullt

Dhe trupin do t`ja falja
Rërës së lagur
Fund-detit të errët
Memorial i fshehur
Dhe e di se deti
S`do t`më tradhtojë

Dhe shpirti le të përkundet
Me ninullën e detit

Kur vallen e dhimbjes
Do e hedhin dallgët qetë
Deti ia thotë ninullës

DANCE OF PAIN

I would love
That the waves of the sea
Carry my soul
In the red twilight
In late summer
In ice water

I would give my body
To wet sand
To the dark bottom of the sea
Hidden memorial
And I know that the sea
Will not betray me

And let the soul rock
With the lullaby of the sea

When the sea waves calmly dance
A peaceful dance of pain
The sea will sing a lullaby

ËNDËRR

Me gjumin hapëron e heshtur
Rrugëve të gjethosura
Mbrëmjeve me erë
Ti s`ndalesh e ec
Është ëndërr
Është jetë
S`të nxjerr dot nga ëndrrat

Shtigjeve të Kësulëkuqes
Endemi çdo natë
S`bashku mbledhim lulet
Stinët ndërrojnë sakaq
Janë rrugët e ngushta
Mali plot me erë
Ecim të përgjumur
Është ëndërr
Është jetë
Nga ëndrrat s'të nxjerr dot

Prej lules në lule
Dehemi pa fjalë
Borëbardhën e humbur
Se gjetëm as këtë natë
Janë kaq rrugë të ngushta
Në malin plotë me erë
Dhe ecim të përgjumur
Është jetë

DREAM

With a dream you silently walk
The leafy streets
On windy evenings
You don't stop and walk
It's a dream
That's life
I can't get you out of my dreams

Along the paths of Red Riding Hood
We wander every night
We pick flowers together
Seasons change in the blink of an eye
The paths are narrow
And the mountain full of fragrance
We walk sleepily
It's a dream
That's life
I can't get you out of my dreams

From flower to flower
We get drunk without words
We didn't find this night either
The lost Snow White
These are such narrow paths
In the mountain full of fragrance
And we walk sleepily
That's life

DALLËNDYSHE

Do të doja
Ta pushtoja syrin tënd
Nga foletë e dallëndysheve
Dhe ta ndjeje cicërimën time
Fluturimin tim
Rreth folesë
Rreth teje

Do të cicëroja ëmbël
Mëngjeseve tua
Do të gdhinim bashkë
Me vesën e luleve
Dhe do të lazdrohesha me ty
Me buzëqeshjen tënde
Rreth teje
Rreth folesë

Dhe nuk do të shtegtoja më kurrë
Do të dimëroja me ty
I strukur në gjoksin tënd
Do të ngrohesha
Netëve të acarta
Dhe do të cicëroja ëmbël
Për mëngjeset e asaj pranvere
Kur unë fluturoja
Rreth folesë
Rreth teje

SWALLOW

I would like
To conquer your eye
From the swallows' nests
And you to feel my chirping
My flight around your nest
Around you

I would chirp sweetly
In your mornings
We would wake up together
With the dew of flowers
I would cuddle with you
With your smile
Around you
Around the nest

I would never migrate again
I would spend the winter with you
I would warm up
Tucked into your chest
On cold nights
And I would sweetly chirp
For the mornings of that spring
When I was flying
Around your nest
Around you

VERËS SË VERDHË

Dielli më dogji përskaj rruge
Verës së verdhë
Me pluhur valë
Rrugën shkelnin kalimtarët
Zemra brofte nga çdo hap

Perëndimi skuqej herët
Lindja nuk zbardhej
Nga dy net larg
Përskaj rruge
Fytyrë zverdhur
Zemra brofte nga çdo hap

Ish një lindje kaq e vështirë
Thashë do jetë një Diell i çrregullt
Era me pluhurin solli lajmin
"Valle krushqish rrugës tjetër"

Zemra iku bashkë me erën
Ndjeu vallen
Dasmë e Verës
Nuse e ëndrrave
Zemra e Diellit
Valle krushqish
Rrugës tjetër

Prapë po them
Se Dielli më dogji
Verës së verdhë
Me pluhur valë
Dhe rrugën shkelnin kalimtarët
Zemra m`brofte nga çdo hap

YELLOW SUMMER

I got sunburnt on the side of the road
In the yellow summer
With hot dust
Passers-by trampled the road
Heart pounded with every step

The west was red early
The east has barely dawned
By two nights away
Along the road
Yellow face
Heart pounded with every step

It was such a difficult birth
I said it would be a messy Sun
A dusty wind brought the news
"The dance of the wedding guests on another road"

The heart is gone with the wind
She felt the dance
Summer wedding
A dream bride
Heart of the Sun
The wedding guests dance
On another road

I am saying it again
I got sunburnt
In the yellow summer
With hot dust
Passers-by trampled the road
My heart pounded with every step

DASMË VERE

Netëve
Kur deti e merr në gji diellin
Dhe dallgët
E mbajnë muzikalitetin e valles
Lum deti
Lum dielli
Lum nata

SUMMER WEDDING

At nights
When the sea embraces the sun
And the waves
Keep the musicality of the dance
Lucky sea
Lucky sun
Lucky night

BREGUT TË DETIT

Hapat lagur
Qiell plot ngjyra piktori
Vetëm
i heshtur hapëron
Dhimbjen tënde kush se mori!

Zhurmë e dallgëve
Sjell ca fjalë që dot nuk shqiten
Është egoizëm i lashtë deti
Gjënë e çmuar ta mbaj për vete

Këmbët lagur shpirt përgjumur
Zemra e falur lindjes së diellit
S`je pulëbardhë t`i truposh rrugët
Dhe të shuash mallin lart mbi detin

Gjumi mbeti përmbi re
Shtrat i shtruar pupla malli
E fshehë lotin errësira
Dielli lind atje pas malit

BY THE SEA COAST

Wet steps
Sky full of colors the painter
Walks alone
In silence
No one took away your pain!

The noise of the sea
Brings some words that can't be detached
It is the ancient selfishness of the sea
To keep the precious thing for itself

Wet feet sleepy soul
Heart given to sunrise
You are not a seagull to cross the roads
And quench the longing above the sea

Sleep remained above the clouds
The bed made with longing feathers
Darkness hid a tear
The sun rises over there behind the mountain

MAGJI VERE

Atje është një lis i lakuar
Një shkumë lumi
Një puthje pezull

Atje është një cicërimë zogu
Një ledhatim plot afsh
Një diell që ngroh ndryshe

Atje është
Një magji vere
Dhe pastaj në dorë mbetet
Një kujtim

SUMMER SPELL

There is a crooked oak
A river foam
An overhanging kiss

There is a bird chirping
A caress full of affection
A sun that warms differently

There is
A summer spell
And then it stays in the hand
One memory

RINJOHJE

Mezi të njoha kur të pashë
Të mbaja mend kur ishe ndryshe
Mallin në gjoks e ndrydha heshtur
Dashuri që përpëlitej

E shkujdesur ti po ecje
Në mes njerëzve atë muzg
Që nga larg numëroja hapat
Sa i huaj ndjehesha unë

Sytë përdhe, flisje me veten
Dhe buzëqeshje si pa shkas
Koha këtu të kish kursyer
Sa u çmalla kur të pash

Zërin tënd prapë se dëgjova
As flokut tënd s`i mora erë
Mora rrugë andej kah erdha
Me *buzëqeshjen* si trofe

S`kthehem më kësaj rruge të ngushtë
Prapë do iki atje larg
Ndryshe jemi pas kaq vitesh
Faleminderit që të pashë

RENEWED ACQUAINTANCE

I hardly recognized you when I saw you
I remember you when you were different
I silently suppressed the longing in my chest
A squirming love

You walked carefree
Among the people in that twilight
I counted the steps from afar
How alien I felt

Eyes down talking to yourself
And smiling as if for no reason
Time saved you here
How pleased I was to see you

I didn't hear your voice again
I didn't even smell your hair
I went in the direction I came from
With a *smile* as a trophy

I will not return to this narrow road
I will go far away again
We are different after so many years
Thanks for seeing you

ENGJËLLIT*

Ç `mund të them për ty
Dhe trupin që e le
Në tavolinën – akull
Ku engjëjt rrinë përmbi
Këtu shpirtrat *grabiten*
Përfëllohen dhimbjet
Është stacion i fundit
Pikënisje ... për gjithësi

Syri kaq i heshtur
Buza s`të lëviz dot
Qafa – mjellmë e zgjatur
Gjoks i pastër – lot
S`pashë të tillë më parë
E tëra flori
Vajzëri e njomë
Që i mungon shpirti

Unë s`ta ndjeva zërin
As zemrën të këndellej
Pashë të vdiste
buzëqeshja
Dhe balli të zverdhej ...
Janë djersët e vdekjes

* Poezi që i dedikohet vajzës së panjohur e cila vdiq derisa punoja në turnin e natës në Klinikën e Kirurgjisë (Prishtinë).

Tingulli të thërriste
Ti s`u ndale dot
Dhe ike ...
Kaq papritur
Sa s`them se
Ti më nuk rron

Pashë qiellin nga dritarja
U humba në kaltërsi
Mbi krahët e engjëjve
Do jesh diku në gjithësi
Dhe trupi rri krenar
Që ty të pati shpirt
Jashtë Toka kërkon borxhin ...
O Zot ...
Qenka kaq e vështirë

P. S.

Unë jam *i panjohuri*
Që luftova për ty

TO AN ANGEL*

What can I say about you
And the body you left
On the table – ice
Where angels stand above
This is where souls are *looted*
The pains are thrown
It is the last station
The starting point... for universe

The eye so silent
Your lips are not moving at all
Neck – elongated swan
Clean chest – tears
I have not seen such before
All gold
Youngling
That lacks soul

I didn't hear your voice
Nor your heart to recover
I saw your smile die
And how your forehead turned yellow...
It is the sweat of death

*This poem is dedicated to the unknown girl who died while i was working the night shift in Clinic of Surgery (Prishtina).

The sound was calling you
You didn't stop at all
And you were gone...
So suddenly
I dare not say
You don't live anymore

I saw the sky from the window
I was lost in the blue
On the wings of angels
You will be somewhere in universe
And the body is proud
That you were his soul
Outside the Earth seeks the debt...
Oh God...
It is so difficult

P. S.
I am the *unknown one*
Who fought for you

JETË E ERËZUAR

Erë të lutem shumë
Shko dhe thuaji asaj
Pas bjeshkëve diku fshihet
Ku dielli zbret ngadalë

Do e gjesh s`do të lodhesh
Ta jap aromën e saj
Ti merre freskinë e gjelbëruar
Ngjallja zemrën ngadalë

Rrëfeja zemrën time
Fill e për pé
Nën rrezet e hënës
Lëmoja flokët asaj

Këndoja ninullat e mija
Kur ajo fle
Ngadalë
Ruaja gjumin – të lutem
Dhe në ëndrra
Foli asaj

Dhe kështu do kalojnë netët
Ditët përplot mall
Do jesh erë e imja
Do jesh erë e saj

Kur tregimet t`mbarojnë
Kthehu tek unë e flasim
Do jem plakur e regjur atëherë
Më gjej me aromën e ballit

Do t`më rrëfesh zemrën e saj
Fill e për pé
Çdo natë
Dhe gjumi do të jetë fresk
Dhe ëndrrat do të jenë mall

SPICY LIFE

Wind, please
Go and tell her
She is hiding somewhere behind the mountains
Where the sun goes down slowly

You will find her, you will not get tired
I will give your her scent
You take the green freshness
Revive slowly her heart

Confess my heart to her
All through and through
Under the moonlight
Smooth her hair

Sing her my lullabies
When she sleeps
Slowly
Don't disturb her sleep – please
And in dreams
Talk to her

And so the nights will pass
Days full of longing
You will be my scent
You will be her scent

When the stories are over
Come back to me and we'll talk
Then I will be old and hardened
Find me with forehead scent

You will confess her heart to me
In great detail
Every night
And sleep will be fresh
And dreams will be longing

GURIT

S`më dhe dorën të ecnim bashkë
Aty mbeta ku më le
Përmbi gur qëndrova ulur
S`nxjerra dot një kokërr zë

Sytë e njomur s`u thanë kurrë
Lagnin gurin që po rritej
Dhe i flisja në gjuhën tonë
U bëmë miq e përtej miqve

Nuk lashë gjë pa i treguar
Pastaj flinim në një gjumë
Çdo mëngjes kërkonte lotin
Sikur foshnja kur do qumësht

Ndërruan stinët ai po rritej
Unë po vdisja pak nga pak
Ai e mësoi tregimin tim
Si ninullë që të vë në gjumë

TO THE STONE

You didn't give me your hand to walk together
I stayed where you left me
I sat on the stone
I couldn't make a sound

Teary eyes never dried
They wet the growing stone
I spoke to it in our language
We became friends and more than friends

I left nothing unsaid
Then we slept in one dream
Every morning it asked for tears
Like a baby when it wants milk

The season changed it was growing
I was dying little by little
It learned my story
Like a lullaby that will put you to sleep

PLAGË DETI

Dallgët ngrihen kodra malesh
Bregu hesht plotë përulësi
Rënkon deti i hidhëruar
Zemërthyer plotë trishtim

Dikush larg ia theu zemrën
Si vaj fëmije kumbojnë dallgët
Era fryn plot nguti
Anë për anë t`ia freskojë plagët

Dielli ulet i fal rrezet
Qielli hapet i fal ngjyrën
E puthin lehtas
Ia lëmojnë plagët
Dhe ai ofshan sikur buzë vdekjes

Dhe ngadalë e mori veten
Dhimbjen fshehu në thellësi
Nata gjumin ia përkundi
Bregu hesht plot përulësi

SEA WOUND

The wave rise up the mountain hills
The shore is humbly silent
The embittered sea groans
With a broken heart full of sadness

Someone far away broke its heart
The waves sound like a baby crying
The wind blows briskly
Side by side to refresh its wounds

The sun is setting and gives its rays
The sky opens and gives its colors
They kiss it lightly
They smooth its wounds
And it sighs as if on the brink of death

And slowly it recovered
It hid the pain deep down
The night rocked his sleep
The shore is humbly silent

DASMË E FTOHTË

Dhe hedhin valle mysafirë të paftuar
Tërë natën e lume në bjeshkën e zhveshur
U dehën, u çmendën, turpëruan nikoqirin
Melodi bajate e një nate të shthurur

Dasma përfundoi pak para agimit
Dhëndri vjen i vetëm me bastun të ngrirë
Mes gjetheve të rëna kërkon shtrat për vete
Ofshanë si në prag vdekjeje
mbulohet me stuhi

Ditën kur u zgjua pas natës së ftohtë
I dha vellon bjeshkës dhe
e pagëzoi *nuse*
S`do vdiste beqar, kështu ishte betuar
Dhe dergjej plotë dhimbje
në bjeshkën e nënshtruar

COLD WEDDING

And the uninvited guests dance
All night long on a bare mountain
They got drunk, went crazy, embarrassed the host
The stale melody of a debauched night

The wedding ended shortly before dawn
The groom comes alone with a frozen cane
He is looking for a bed among the fallen leaves
He sighs as if on the verge of death, he was
covered by a storm

The day he woke up after a cold night
He gave the veil to the mountain and
baptized it as a bride
He won't die single, he swore to that
And he languished in pain down
the submissive mountain

IMAZH

Imazhin tënd ma sjell nata
Kur mbyll sytë të të harroj
Vjen plotë hire e lazdruar
Dhe rrimë bashkë derisa agon

Ngre mbulesën
të të bëjë pak vend
Afër të mbaj e s`të prek dot
S`hap dot sytë, kam frikë se ikën
Flasim, çmallemi nëpër lot

Vijnë mëngjeset, ah mëngjeset
Ti nuk je, është shtrati i ngrohtë
S`hap dot sytë, nuk e dua dritën
Pres të erret nëpër lot

IMAGE

The night brings me your image
When I close my eyes to forget you
It comes full of grace and pampered
And we stay together until dawn

I'm pulling back the covers
to make some room for you
I hold you close and I don't touch you
I can't open my eyes, I'm afraid you'll run away
We talk, through tears we satisfy our longing

Mornings come, ah mornings
It's not you, it's the warm bed
I can't open my eyes, I don't want the light
I wait for the dark through tears

MALL DIMRI

S`mbuloj dot mallin për ty
As fërfëllizën reshjeve të borës
Zemra ik në marrëzi
Vjen e rrah në gjumin tënd

Ngrysur – zbardhur
Kësaj nate të ftohtë
End mallin ky qytet i ngrirë
qosh më qosh
me fërfëllizë

Dhe shumë dimra sikur ky
Do na gjejnë pranë qelqit shtangur
Do endim mallin rrugëve të ngrira
Me reshje të borës
Fërfëllizë

WINTER LONGING

I can't cover the longing for you
Not even the flurry of snowfall
The heart flees into madness
It comes and beats in your sleep

Gloomy – bleached
On this cold night
This frozen town
Weaves the longing
From corner to corner
Sleet

And many winters like this one
Will find us stunned by the glass
We will weave the longing on icy roads
With snowfalls
Sleet

MIKES SIME

Ecëm heshtur me kokat ulur
Krah për krah e dalëngadalë
Rrugë e gjatë ky mall i heshtur
Në pole të globit larg e më larg

S`folëm gjë se fjalët ikën
S`mbeti vend më për ato
Rrugët akull gjarpëruar
Shpirti i thyer copë më copë

Oh moj mike se ç`na gjeti
S`qemë mësuar kështu të rrojmë
Në vend se këngë t`i thurim verës
Do e qajmë dimrin mot për mot

TO MY OLD FLAME

We walked in silence with bowed heads
Hand in hand and slowly
It's a long way this silent yearning
At the poles of the globe far and away

We didn't say anything because the words were gone
There was no more room for them
Winding ice roads
A soul shattered into pieces

Oh, my old flame what happened to us?
We are not used to living like this
Instead of singing about summer
We will mourn the winter year after year

PRANVERËS

Këtu së pari ra pranvera
Dhe iku maleve
Rrjedhës së lumit
Magjinë e saj e barti era
Gjeth pas gjethi
E dru pas druri

Do të jesh zgjuar sot nga gjumi
Se ëndrrat ikën rrjedhës lumit
S`do më kesh pranë do përgjërohesh
Kush s`qan kokën pse ti lëndohesh

Vaj të qyqeve të sjell mali
Dhe ti rrëzë lisi rri ngushëllohesh
Kush s`të prek shpirtin
Kush s`t`thanë lotin
Është vaj pranvere
Është mall i motit

Do gjesh emra të shkruar drunjve
Që rriten e bien se janë lëvore
Dhe rrugëve të ngushta
gjetheve të malit
S`do më gjesh mua
do lodhesh koti

Do vijë vetë
Më prit te Guri
Aty ku rrjedha zhurmon e çmendur
Është rruga ime, nuk është rrugë stine
Se din as lumi
Se din pranvera

TO THE SPRING

Spring came here first
And fled to the mountains
Along the river
Its magic was carried by the wind
Leaf after leaf
And tree after tree

Today you will wake up from your dream
Because dreams run away with the flow of the river
You won't have me around, you'll be begging
Nobody cares why you get hurt

The mountain brings you a cuckoo's cry
And you sit near the oak tree and console yourself
Nobody touches your soul
There's no one to dry your tear
It is the cry of spring
It is the longing of time

You will find names written on trees
They grow and fall because they are bark
And through the narrow paths
through mountain leaves
You will not find me
you will tire yourself for nothing

I will come alone
Wait for me by the Stone
Where the stream roars madly
It's my road, it's not a seasonal road
Not even the river knows
Even spring does not know

LIQENIT

Ika
Dhe të lash
Me shiun që përplasej në Ty
Me ofshamën tënde
Mjegull
Mbuloja jote besnike

Ika
Dhe nuk munda
Të të marr me vete
Në gji
Të të përkund
E të fle me Ty
Dhe të të mbulojë
Me mbulojën time

Oh Liqe...Liqe
Dhimbja ime e çuditshme
Marrëzia e netëve të mija
Kam mall për Ty
Mall çmendurie

Ti nuk paske shtrat për mua
Ndaj s'më mbetet tjetër
Veçse të endem brigjeve tua

Përjetësisht

TO THE LAKE

I ran away
And I left you
With the rain crashing into You
With your sigh
Fog
Your faithfull cover

I ran away
And I couldn't
Take you with me
In my chest
To rock you
And to sleep with you
And to cover you
With my cover

Oh, the Lake...the Lake
My strange pain
The madness of my nights
I miss you
My crazy longing

You don't have a bed for me
So I have no choice
Except to roam your shores

Endlessly

MAGJI

Atje është një lis i lakuar
Një shkumë lumi
Një puthje pezull

Atje është një cicërimë zogu
Një ledhatim plot afsh
Një diell që ngroh ndryshe

Atje është
Një magji vere
Dhe pastaj në dorë mbetet
Një kujtim

SUMMER SPELL

There is a crooked oak
A river foam
A lingering kiss

There is a bird chirping
A caress full of affection
A sun that warms differently

There is
A summer spell
And then a memory remains
In the hand

NDRYSHE

Me emrat më të bukur
Të thërrisja Ty
Dhe erërat lazdroheshin
I bartnin në gjithësi
Retë nuse të bardha
Dielli i skuqur flakë
Në Tokë stinë e luleve
Në qiell bëhej dasmë

Sot
Skulptura të zhveshura
Pranë rrugës së vjetër
Ironi e së kaluarës
Heshtje e vdekur
Dhe rruga është e terur
Me pluhurin flori
Qiell i errësuar
Diell gjysmë i ngrirë

S`kam më forcë të të ndjek
Ti ke hapa ndryshe

Skaj rrugës po plakem
Po rroj me dallëndyshet
S`do kujtohesh për mua
As kur të jem tretur
Dhe shtigjeve plotë dritë
S`shtegtoj dot me ty

DIFFERENTLY

With the most beautiful names
I called You
And the winds were spoiled
They carried them in universe
Clouds as white as a bride
The sun red as flame
Flower season on Earth
And the wedding was in heaven

Today
Naked sculptures
Near the old road
The irony of the past
Dead silence
And the road is dry
With gold dust
Darkened sky
The half-frozen sun

I don't have the strength to follow you anymore
You have a different step

I'm getting old by the side of the road
I live with swallows
You won't remember me
Not even when I am wasted
And through paths full of light
I will not walk with you

TY

Ty që malet të fshihen
Mjegullave të mëngjesit
Pelerinës së natës
Shtigjeve të ngushta

Ty, që të ushqeu aroma-gjeth
E të lau kroi-lot
Gjumin ta përkundën degët e njoma
Të fshehën e të rritën

Ty, që nga përrallat desha të të nxirrja
Kaherë
Heroinë e netëve të mija
Busulla ime e humbur

Ty që qielli të bekoi
Shenjtëri qielli
Shenjtëri mali
E ti më beko të lutem
Më beko

YOU

You to whom the mountain hides
In the morning mists
In a nightgown
In narrow paths

You, whom the leaf-scent nourished
And washed the fountain-tear
Wet branches rocked your sleep
They hid you and raised you

You, who I wanted to pull out of fairy tales
Long time ago
Heroine of my nights
My lost compass

You, whom God has blessed
The holiness of heaven
The sanctity of the mountain
And you bless me, please
Bless me

TË LUTEM EJA

Jetës nuk i dihet asnjëherë
Ti eja si të duash
Me borën
Me shiun
Me erën

Vetëm eja
Të lutem!

PLEASE COME

You never know anything in life
You, come as you wish
With snow
With rain
With the wind

Just come
Please!

KËNGË VJESHTE

Rrugët janë bërë qull
E di se në këtë qytet diku
Pikon streha jote

AUTUMN SONG

The roads are wet
I know that somewhere in this town
Your shelter is dripping

TINGUJT E SHIUT

Era u ndërron melodinë
Pikave të shiut
Janë përzierje tingujsh
kujtimesh

Aty janë binarët
Ecja e lagur me ty
Dhe treni që pas na ndiqte

SOUNDS OF RAIN

The wind changes the melody
Of the raidrops
They are mixtures of sounds
Memories

There are the rails
That wet walk with you
And the train that followed us

LUMIT

Lumi s`mori veten
U tha e përroskë u bë
Shtrati mbeti zbrazur
Mbuluar nga kallamet

Vdiqën dhe u varrosën
Peshqit që kishin mbetur

Zhurma humbi kreshtave
S`mbeti krenari
Ec heshtur i përulur
Është rrugë e nostalgjisë

Mbretëri bretkosash
O mallkim i rëndë
Çdo gur fsheh një varr
Çdo gur e lanë një lot

TO THE RIVER

The river did not recover
It dried up and turned into a stream
The riverbed remained empty
Covered with reeds

The fish that was left
Died and was buried

The noise was lost in the ridges
There was no pride left
I walk silently and humbly
It's the path of nostalgia

Frog kingdom
O heavy curse
Every stone hides a grave
Every stone was washed away by a tear

MAKTH NATE

Përmbi dhimbjes tënde përkundem
Dhe maktheve të natës lundroj
Në lotët e tu rrëke
Ku ta marr atë gjumë e të fle

Dhe i mbyll sytë e ik larg
Atje ku era fryn e ftohtë,
Vjeshtës së verdhë
Ku lëndina qiellin prek
Dhe lulet dridhen si purtekë

Dhe lutjet ia them qiellit atje
Edhe lotët, edhe dhimbjen
Dhe pastaj strukem, bëhem gur
Në errësirë jam një pikë më shumë

Pastaj faqeve tua rrëshqas, e zbres
Rreth buzëve të lagura pa jetë
Dhe në gjoksin tënd nis e përkundem sërish
Ku ta marr atë gjumë e të fle

NIGHTMARE

Over your pain I rock
And I sail through the nightmares
In your flowing tears
Where can I find that dream and sleep

And I close my eyes and run away
Where the wind blows cold
In the yellow autumn
Where the lawn touches the sky
And the flowers shake like a leaf

I pray to heaven there too
And tears and pain
And then I crouch, I turn into stone
I am one more drop in the dark

Then I slide down your cheeks
Around wet lifeless lips
And on your chest I start to rock again
Where can I find that dream and sleep

RESHJE BORE

Mëngjesi erdhi
Pas dritares së lagur
Përsëri po pres
Që flluskat e borës
Të ndërtojnë imazhin tënd

SNOWFALL

The morning has come
Behind the wet window
I am waiting again
For snowflakes
To build your picture

PO VDES

Po vdes
Me djersët që ballin ngushëllojnë
Dhe dhimbja përdridhet e lazdruar
Është natë
Dhe nuk zbardhëllon kurrë!

Po vdes
Bohem i vetmuar
Me hijen që më ngulfat
(Pantomimë muresh e frikshme)

Po vdes
Dhe ndjej dhimbjen të shuhet
Do të jetë gjumë i vdekjes
Ah sikur ta dija
Sikur ta dija
Ah

I AM DYING

I am dying
With sweat soothing the forehead
And the pain fondly squirms
It's a night
And it never dawns

I am dying
A lonely bohemian
With a ghost that suffocates me
(Scary pantomime of walls)

I am dying
And I feel the pain go away
It will be a dream of death
Ah, if I only knew
If I only knew
Ah

VALLE VARRESH

Seç u zgjove sot nga varri
Hije-hije njësh me erën
Nuse fjetur, nuse zgjuar
Balerinë e bardhë e qeshur

Maje gishtash rrotullohesh
Mbi një varr pastaj një tjetër
Buzëqeshë e s`prekë në tokë
Sikur heq mallin e jetës

Shpirt e trup i larë në fresk
Bukuri e botës tjetër
Valle varresh pa muzikë
Dhe spektatorë kaherë të fjetur

Kur vrapi yt nis e lodhet
Dhe dielli plaket e ik në qiell
Hije-hije siç u zgjove
Nis e fle tek shtrati yt

Matanë varreve skaj kaçubës
Janë dy sy për mall të etur
Somnabul në mes të dy jetëve
Spektatorë gjysmë i fjetur

GRAVE DANCE

Today you woke up from the grave
Ghost-ghost identical with the wind
Sleeping bride, awake bride
Smiling white ballerina

You're spinning on your tiptoes
On one grave and another
You smile and do not touch the ground
It's like you're putting away your longing for life

Body and soul bathed in freshness
Old world beauty
Grave dance without music
And the spectators have long since fallen asleep

When your running starts to tire
And the sun grows old and flees into the sky
Ghost-ghost as you woke up
You start sleeping in your bed

Over the graves by the bushes
There are two eyes for longing
Somnambulist between two lives
Spectators half asleep

SOMNABUL

Se do të të dua dhe ditëve të errëta
Kur qielli mrrolet mbushur vrer
Hap pas hapi fushave të zbehura
Gjysmë zgjuar
Gjysmë fjet

Kam aq mall sa ëndrrat tranden
Dhe gjumi ikën vrap e vrap
Somnabul djerrinave të verdha
Janë net pa yje
Janë net pa hënë

As ditë
As natë
S`gjej gjurmët e tua
Dhe s`fluturove këtë e di
Por kush qe ai që të shkeli gjurmët
Dhe më çmendi mallin për Ty

Fushave të zbehura
Dhe djerrinave
Atje do të gjej një natë pa hënë
Unë somnabul
Ti gjysmë e vdekur
Mbetet halli
"si do t'ia bëjmë"

SOMNAMBULIST

That I will love you even in the dark days
When the sky is gloomy full of bile
Step by step through the faded fields
Half awake
Half asleep

I crave so much that my dreams are shaking
And the dream fled
Somnambulously through the yellow wasteland
Those nights are starless
Those are moonless nights

Not even during the day
Not even at night
I can't find your tracks
And you didn't fly, I know that
But who was he who stepped on your footsteps
And drove my longing for You crazy

On the faded fields
And in the wasteland
I will find you there on a moonless night
I am a somnambulist
You half dead
The problem remains
"how we are going to get out of this"

ELEGJI VJESHTE

Dhe vjeshta
Ka thur një shtrat me gjethe
Përkundë vëllanë
Të sëmurë
Në prag vdekjeje

Dhe ninullat
Edhe lotin
I bart stuhia

Këngë për vëllanë
Vaj për vëllanë
Lum vjeshta
Mjerë vjeshta

AUTUMN ELEGY

And autumn
Has woven a bed of leaves
It's rocking its brother
Sick
On the verge of death

And lullabies
Even tears
The storm takes them away

A song for a brother
A cry for a brother
Lucky autumn
Poor autumn

LUTJE

Sot do hapësh syçkat
Prapë mëngjes i ftohtë
Retë përplot me ëndrra
Shtrati qull i ngrohtë

Si s`ndërruan mëngjeset
Stinët do mallkosh
Ndjen trupin të kalbet
Dhe shtrati s`ta njomë dot

Këmbët kaq të lodhura
Shpirti mal me borë
Hapat gjysmë të fjetur
Tokë që kurrë s`gjelbëron

Është fushë e njelmosur
E zverdhur gjer në palcë
Këtej s`vijnë shtegtarët
Është mallkim i lashtë

Urë e drunjtë luhatet
Lum i turbullt-baltë
Askush s`vjen këtej
Askush s`del matanë

Do lutesh- përulur
Engjëjt s`zbresin dot
Dielli fle pas maleve
Shtrati qull i ngrohtë

PRAYER

Today you will open your eyes
It's a cold morning again
Clouds are full of dreams
Bed wet and warm

How come the mornings didn't change
You will curse the seasons
You feel that the body is rotting
And the bed can't wet it for you

Legs so tired
Your soul a mountain with snow
Half asleep steps
Land that never turns green

It's a saline soil
Yellowed to the core
Migrants don't come here
It's an ancient curse

The wooden bridge is swaying
A river of muddy water
Nobody comes here
And no one crosses over to the other side

You will pray – humbly
But the angels will not come down
The sun sleeps behind the mountains
Bed wet and warm

DASHURI DETI

Këtu mbaron tregimi
Për dashurinë e detit
Dhe pulëbardhën
Që shtegton maleve

Sonte është natë
Dhe në breg
Një vaj violine
Vajton ikjen

Nën tingujt e saj
Deti lutet
Plotë dallgë e vaj
Zot, ruaje pulëbardhën!

SEA LOVE

This is where the story
Of sea love ends
And the seagull
Flying over the mountains

Tonight is the night
And on the coast
The cry of the violin
Mourns the leaving

Under its sounds
The sea is praying
Full of waves and cries
God save the seagull!

MURGESHË KRESHTASH

Atje fshihesh Ti
Atje ku Dielli e bën gjumin
Atje ku nata vesh dhe zhvesh mbulojën
Atje ku ujëloti mbush pellgjet
Dhe zëri tretet kreshtave
Mureve

Dhe Ti i shërben Diellit
Natës
Pellgut
Murgeshë kreshtash

Dhe ata të përrallosin
Për fushat e blerta
Për shtratin valë netëve të ftohta
Për dasmën e Lum-Detit
Princeshë përrallash

NUN OF THE RIDGES

That's where You are hiding,
Where the sun sleeps
Where the night wears and removes the veil
Where water-tear fills the ponds
And the voice fades in the ridges
In the walls

And You serve the Sun
The night
The pond
You the nun of the ridges

And they will tell stories
About green fields
About curling up in bed on cold nights
About the wedding of the River-Sea
Fairy tale princess

ECJE E PLAKUR
(Salzburgut)

Këtu buron plakja
Rrënjëve të kështjellës
Dhe zbret rrugëve të gurëzuara
Tek faltore e vjetër

Eci rrugëve të ngushta
Pranë shtëpisë së mbetur
Ku tingujt mësuan vrapin
Dhe Tokës i prekën zemrën

Ecja zvarritet skaj lumit
Dhe i plak brigjet me shekuj
Dhe uji është më ndryshe
Është i kohës tjetër

Dhe shtëpitë pushtohen
Nga trokëllimë e nëmur
Askund vaj i foshnjës
Këtu lindin të vjetër

OLD WALK

(To Salzburg)

This is where aging originates
In the roots of the castle
And the cobbled streets
To the old shrine

I walk through narrow streets
Near the remaining house
Where the sounds learn to run
And touched the heart of the Earth

The walk crawls along the river
And ages the shores for centuries
And water is different
It's from another time

And houses are invaded
From cursed knocking
No baby crying anywhere
Old ones are born here

GURINËS
(Salzburgut)

Mes përrenjve të mallkuar
Që Djalli i bekoi kaherë
Varre të gurëzuara
Që ruajnë një copë dhé

Një statujë përulur
Ka shekuj që lutet
Dhe Faltoret tringëllojnë
Për rrugën e humbur

Dhe këtu është madhështia
E ngritur mbi gur
Gjithçka është e plakur
Edhe zemrat në mur

STONY GROUND

(To Salzburg)

Among accursed streams
Which the Devil blessed long ago
Stoned graves
Which guard a piece of land

A humble statue
Has been praying for centuries
And the Shrines are ringing
For the lost road

And here is the greatness
Built on stone
Everything is old
Even the hearts on the wall

GJURMËVE TË DHIMBJES

Më bëhet se ndjej hapat
Që në melodi zbërthehen
Mjerë Gurina e mjera
Për Djalin* që s`kthehet dot

Lumi kujton kohën
Kur ishte më ndryshe
Djaloshi këtej endej
Zogjtë mësonin cicërimën

Dhe muret e Kështjellës
Mbi dhimbje qëndrojnë
Këtej Vdekja vërdalloset
Këtej lotët s`pushojnë

Janë mëngjese të errëta
Dita s`vërehet dot
Është heshtje ndjellakeqe
Tokë e larë në lot

* *Mozarti*

AFTER THE TRACES OF PAIN

I feel footsteps
Which turn into a melody
Poor Stony Ground, wretch
For the Boy* who will never come back

The river remembers time
When it was different
The boy wandered here
The birds learned to chirp

And the walls of Castle
They stand on pain
Here Death walks around aimlessly
The tears never stop here

The mornings are dark
The day can be hardly distinguished
It's an ill-omened silence
A land washed in tears

* *Mozart*

VAJ MURGU

Unë kujtova se ke vdekur
Lutjeve t`mija u dhashë udhë
Dhe vajtoja vdekjen tënde
Ag e terr u bëra gur

Nuk e dija se ku preheshe
Në t`katër polet asnjë gjurmë
Ditë për ditë nga pak po vdisja
Ti e humbur e unë murg

Nuk e din sa shumë u luta
E floku zbardhej pak nga pak
Vdekja mike dot s`më bëhej
Mjekërbardhë u bëra plak

Stinët ndërroheshin si çarçafët
Dhimbjen mbështillnin si jorgan
Një ofshamë për ty lëshoja
Një ofshamë për trupin varrë

Dhe atë natë në kthinën time
Tek po vdisja me të vërtetë
Ti u ktheve hape derën
Dhe më dhé edhe pak jetë

S`dukesh njëjtë, si kur të humba
Tek m`lag ballin e më thërret
Je shumë ndryshe, s`je si lumi
Por të ndjeva si atëherë!

T`i kam falë lutjet e mija
Të mbështjella n`copëza jete
N`këto pak ditë që më kanë mbetur
Lërmë të të dua si atëherë.

MONK'S CRY

I thought you died
I gave way to my prayers
And I mourned your death
I was completely turned to stone

I didn't know where you were resting
There is no trace on all four poles
Day by day I was dying little by little
You are lost and I am a monk

You don't know how much I prayed
My hair turned white little by little
Death could not become my friend
I am white-bearded and old

The seasons changed like sheets
They wrapped the pain like a quilt
I sighed for you
A sigh for my wounded body

At that night in my niche
When I was really dying
You turned and opened the door
And gave me a little more life

You don’t look the same as when I lost you
While you wet my forehead and call me
You are much different, you are not like a river
But I felt you like then!

I gave you my prayers
Wrapped in pieces of life
In these few days that I got left
Let me love you like I used to

ITINERAR I CAKTUAR

(Spitaleve të Prishtinës)

Këtu
Puhia
Bartë shpirtrat
Dhe shikimet shtangen
Kah qielli
Dhimbja derdhet vrullshëm
Rrugëve të ngushta
Pranë shelgjeve vajtuese

Këtu
Shpirtrat dergjen
Pa shpresë
Në krahë të engjëjve
Itinerar i caktuar
Zogjtë shëtisin
Dritareve
S`ka lajme
Për ata që shkuan
As sot
As nesër
As...kurrë

DESIGNATED ROUTE

(To Prishtina hospitals)

Here
The breeze
Carries souls
And the views are stunned
Towards the sky
The pain pours vigorously
Through narrow streets
Near the weeping willows

Here
Souls languish
Hopelessly
In the arms of angels
Designated route
Birds move
From one window to another
No news
For those who left
Not even today
Not even tomorrow
Not even...ever

YLLIT

Qëndro mbi mua të lutem
Dhe ma fërko ballin flakë
Këndoma ninullën dhe gëzohu
Për yllin që po lind sot

Gjithësia do të jetë më e ndritur
Dhe ky është ylli ynë polar
Ti më përkund me melodinë tënde
Dhe mos thuaj më, asnjë fjalë!

Ma mbaj kokën skaj zemrës
Dhe më mbulo me flokët mëndafsh
Më deh me aromën tënde dhe gëzohu
Për yllin që po lind sot!

STAR

Stay above me please
And rub my flaming forehead
Sing me a lullaby and rejoice
For the rising star today

The universe will be brighter
And this is our North Star
You rock me with your melody
And don't say a word anymore!

Hold my head close to the heart
And cover me with silken hair
Intoxicate me with your fragrance and rejoice
For a rising star today!

ENGJËLLIT TË FJETUR

Dhe të lash ashtu të fjetur
Thellë nën rrënjë të lisit plak
Me plotë gjethe t`shtrova shtratin
Pa frymë ika nëpër mal

Nuk të zgjoja dot nga ëndrrat
As me lutje, as me vaj
Dhe ninullave, e shterja zërin
Gjumë e vdekje përmbi mall

Dhe me kokën kap ndër duar
I thirrja Qiellit si i marrë
E imja është! O Zot të lutem
Më ndihmo, ma zgjo në këtë natë!

Pastaj yjet u bënë varg
Dhe ia dhashë vrapit, rrugës së Qiellit
Këmbët në tokë e shpirtin lart
Drejt magjisë ninullës Së zgjimit

Dhe kur yje nuk pat më
Dhe qielli skuqej si nën faj
Skaj një lumi ndala vrapin
Kah t`ja mbaja, kah të shkoj

TO THE SLEEPING ANGEL

And I left you to sleep like that
Deep under the roots of an old oak tree
I made a bed for you full of leaves
Out of breath I ran across the mountain

I couldn't wake you from your dreams
Not by prayers, not by crying
And lullabies, I strained my voice
Sleep and death over longing

And I had my head in my heads
I called Heaven like a fool
O she's mine! Oh God please
Help me, wake her up in this night!

Then the stars aligned
And I ran, on my way to Heaven
Feet on the ground and soul up
To meet the magic of awakening lullabies

And when stars were gone
And the sky turned red as if under guilt
At the edge of the river I stopped running
Where to run, where to go

AG MËNGJESI

Kur agu vije somnabul
Sikur e zgjon natën nga gjumi
Nis e shtrihet tek shtrati i saj
Dhe fle si foshnjë në krah të nënës

Pastaj rrezet vijnë e ngrohin
Dhe nis e zgjohet dalëngadalë
Skaj moçalit me dy lejlekë
Dhe fushës verdhë pa asnjë mal

Kah mbet rruga kah t`ja mbaj
Veç verdhnajë dhe qiell lejlekësh
Një kështjellë mbrëmë ishte zgjuar
Dhe përskaj saj një mulli ere

MORNING DAWN

When dawn comes like somnambulist
It's like waking up the night from a dream
She started and lay down on her bed
And she sleeps like a baby in her mother's arms

Then the rays come and warm her
And she slowly starts to wake up
On the edge of a marsh with two storks
And a yellow field without any mountain

Where the road disappeared and where should I go
Everything around turned yellow and the sky was full of storks
A castle last night was awake
And next to it a windmill

MUZA IME

Sikur zhurmë e shiut kur mëngjesin sjell
Teksa rrotullohem në shtratin e ngrohtë
Udhëtoj në kohë, atje ku më dërgove
I vdekur për pak gjumë e sytë nuk mbyllen dot

Çka të them sot ty që
nga kohërat tjera erdhe
Flasim të njëjtën gjuhë dhe qeshim njësoj
Dehem kur të shoh vdes nga lumturia
Jam kaq i përgjumur dhe sytë nuk mbyllen dot

Oh ikona ime, muza e netëve të mija
Me dashurinë e nënës mbështillem rreth teje
Kaq i vogël ndihem vdes për mëshirën tënde
E dua zërin tënd si një ninullë nate

Asnjëherë s`kuptova cili udhëtoi në kohë
Vetëm se kjo kohë nuk është koha ime
Por i vogël po ndihem e çdo ditë po rritem
Mbështetur në gjoksin tënd

MY MUSE

Like the sound of rain when morning comes
As a roll over in a warm bed
I travel in time, to where you sent me
Dead tired for a little sleep but I can't close my eyes

What should I tell you today since
you came from another time
We speak the same language and laugh the same
I get drunk when I see you and I die from happiness
I am so sleepy but I can't close my eyes

O my icon, muse of my nights
I wrap myself around you with motherly love
I feel so small I'm dying for your mercy
I love your voice like a lullaby at night

I never understood who traveled in time
Only this time is not my time
But I feel small and growing every day
Leaning on your chest

NË STACION TRENI

Një copë zemre e lashë këtu
Kur treni gjëmoi e morri udhë
Një peizazh që shkarravitej
Gri e bardhë si një pikturë

Si ritëm zemre, zhurmë e rrotave
Në binarët e shtrirë për dhe
Jam me Ty aty ku zbrite
Dhe një statujë brenda në tren

Janë stacionet të lara në lot
Ku malli shkundet e shkapërderdhet
Këtu të gjeta e këtu të lashë
Si një thesar në mes të humnerës

Qiejt ndërrojnë ngjyrat e treni ec
Është shtegtar me ritëm zemre
Klithmë e tij m`i trishton ëndrrat
Kruspull fle dhe i pres mëngjeset

AT THE TRAIN STATION

I left a piece of my heart here
When the train roared and left
A landscape that was scribbled
Gray and white like a painting

Like a heartbeat, the sound of wheels
On the rails lying on the ground
I'm with You where you got off
And the statue inside the train

These train stations are washed with tears
Where longing shakes and dissipates
This is where I found you and this is where I left you
Like a treasure in the middle of the abyss

The sky changes colors and the train moves
It's a migrant with a heartbeat
His cry saddens my dreams
I sleep curled up and I wait for the mornings

MONOLOG

Dorën po kërkoj
Në çdo qoshe rruge
Ku shkelën këmbët tona
Errësirë pas errësire
Faqen ta faqos
N`bardhësinë e pëllëmbës
Dhe gjumit do ia fal
Pastaj krejt kujtimet

Unë foshnja e jote
Që më linde vonë
Më hodhe mes përrenjve
Dhe "s`më deshe dot"
Lakuriqët më rritën
Që nga ajo natë
Dhe përkundem në ecje
Nga qoshja në qosh

MONOLOGUE

I am looking for a hand
On every street corner
Where our feet have trod
Darkness after darkness
To caress your cheek
In the whiteness of the palm
Then all the memories
I'll put them to sleep

I'm your baby
That you gave birth to me late
You threw me between streams
And "you never loved me"
I was raised by bats
Since that night
I stumble
And I sway as I walk
From corner to corner

NOSTALGJI

Këtu është vendi
Ku vera e puthi në faqe vjeshtën
Dhe shkoi
Me valixhet plot mall

Dhe mbeti nostalgjia
Ekskavator shpirti
Në vallen e gjetheve
Mbrëmjeve bosh

Gjumi rëndon qepallat
E zogjve të strukur
Tek presin agun kot
Se ajo nuk është më

NOSTALGIA

Here is the place
Where summer kissed autumn on the cheek
And left
With suitcases full of longing

And the nostalgia remained
Soul excavator
In the dance of leaves
In empty evenings

Sleep weighs down the eyelids
Of crouching birds
Waiting in vain for the dawn
Because she isn't here any more

NET MALLI

E hapa derën tënde të mbyllur
Dhe hyra
Ti s`i ndjen hapat e mi
Unë mezi marr frymë
Një tik-tak ore mban ritmin
Unë mbaj ritmin e saj
Ngadalë afrohem tek ti

Dhe ndalem pranë shtratit
Me zemrën që po më pëlcet
Shoh syrin që të fle
Buzën që s`ta puth dot
Jam i huaj në dhomën tënde
(Hyra pa leje
Më vjen keq)

Dhe tani
Kam frikë ta pres agun
Po ik
Dhe do të kthehem
Netëve të mallit
Të trishtimit
Do jem këtu me ty

Me syrin e fjetur
Dhe buzën e paputhur
Dhe agimet do i gdhijmë veçmas
S`i gdhij dot me ty
Nuk e di pse kam frikë
Kam frikë
Kam frikë

NIGHTS OF LONGING

I opened your closed door
And I entered
You don't feel my steps
I can hardly breathe
A ticking clock keeps the rhythm going
I keep up with its pace
I slowly approach you

And I stop by the bed
With my heart breaking
I see your eye sleeping
The lip that I can't kiss
I am a stranger in your room
(I entered without permission
I am sorry)

And now
I am afraid to wait for the dawn
I am running away
And I will be back
In the nights of longing
Of sadness
I will be here with you

With a sleepy eye
And an unkissed lip
And we will spend the nights awake separately
I don't want to spend them with you
I don't know why I am afraid
I am afraid
I am scared

EKSTAZË PËRVËLUESE

S`mërzitem kurrë me ty
As kur shiu të bën dush
Muzgjeve të pranverës
Dhe lulet përulen të lagura
Në fustanin gjelbëruar
Unë me ty lagem
Unë me ty thahem
S` mërzitem kurrë me ty

Si nuse e zbukuruar
Plotë fresk e magji
Gjelbërohesh e zverdhesh
Je nur i bukurisë
Këmba s`shkel mbi ty
Rri skajeve të vështroj
Me ty digjem
Me ty përvëlohem
S'mund t'mërzitem kurrë me ty

BURNING ECSTASY

I'm never bored with you
Not even when the rain pours down on you
In the spring twilights
And the flowers bow down wet
In a green dress
I get wet with you
I am drying with you
I'm never bored with you

Like a beautified bride
Full of freshness and magic
You turn green and yellow
You are grace of beauty
No footsteps on you
I hold on to the edges to look at you
I burn with you
I suffer terribly with you
I can never get bored with you

SHTEGTAR I VONUAR

Shumë kohë më parë
Malet e tradhtuan
Ia morën ylberin
Prej duarve të tij
E çmendën
E trishtuan
Dhe ai s`ndalet së kërkuari
I tij është ylberi
Është fryma e tij

Është ecje pa gjurmë
Rrugës së shkretuar
Me veriun pas vetes
Si qen endacak
Tek i flet çdo druri
Në malin e tharë
Me kokën përulur
Është ecje e bardhë
Është fryma e tij
I tij është ylberi

LATE MIGRANT

Long time ago
The mountains betrayed him
They took away the rainbow
From his hands
They drove him crazy
They made him sad
And he doesn't stop looking
It's his rainbow
It's his breath

It's walking without tracks
On a deserted road
With the north behind
Like a stray dog
And he speaks to every tree
On a dry mountain
With bowed head
It's a white walking
It's his breath
The rainbow is his

VETMI

Thellë në palcë
E ndjej vetminë
Pikave të shiut
Si në këtë natë
Qiell i çmendur vetëtinë
Gjumë i humbur
Shtatë bjeshkë larg

S`nxjerr dot zemrën
T`ja fal shiut
Dhe heshtja syrin t`ma palosë
Përtej dhimbjes
Përtej mallit
Botës së luleve i qetë të rroj

Krejt i vetëm
Krejt pa ty
Shoh zbrazëtinë që mbeti prapa
Rrugën tënde
Gjurmët tua
I fshiu shiu
I mbuloi nata

SOLITUDE

Deep down in my core
I feel lonely
Raindrops
Like on this night
Lightning in the crazy sky
Lost sleep
Seven mountains far away

I can't take my heart out
And to give it to the rain
And silence to close my eye
Beyond the pain
Beyond the longing
To live peacefully in the world of flowers

All alone
Completely without you
I see the void left behind
Your way
Your footprints
The rain washed them away
The night covered them

HIMNI I TMERRIT

Në skenë një *aktor i marrë*
Suflerët *vlojnë* pas perdeve
Dhe papritmas një britmë:
Ndal

Aktori ik skajeve, kokulur
Suflerët vazhdojnë punën e tyre
Dhe fillon kënga e quajtur *Himn*
Askush nuk lëviz

Rroftë këpuca e lustruar
Vrit çdo zog që s`këndon Himnin
Dhe duartroket publiku
Në ekstazë

Bien perdet
Në skajin e skenës, pushoi britma dhe mallkimi
Një trup i ftohtë tërhiqet zvarrë
Gjakos skenën

Dhe refreni i Himnit
Vazhdon të këndohet
këndohet

ANTHEM OF HORROR

A *crazy actor* on stage
Prompters *seethe* behind the curtains
And suddenly a shout:
Stop

The actor runs to the edges, bows
The prompters continue their work
And the song called *Anthem* begins
Nobody moves

Long live the polished shoe
Kill every bird that doesn't sign the Anthem
And the audience applauds
In ecstasy

Curtain falls
At the edge of the stage, the shouting and cursing stopped
A cold body is dragged
And bleed the stage

And the refrain of the Anthem
Continues to be sung
to be sung

ZJARR

Unë nuk jam piroman
Këtu po sodisja pyllin
Dhe flakët erdhën vet
Më besoni ...

FIRE

I am not a pyromaniac
Here I was contemplating the forest
And flames came by themselves
Trust me...

PËRMBAJTJA / CONTENTS

E PAZAKONTË....6
SO UNUSUAL....7
PRAG VDEKJEJE....8
THE BRINK OF DEATH....9
MJEGULL....10
FOG....11
I ÇMENDUR....12
CRAZY....14
MALLKIM....16
CURSE....18
PËRKUNDEM....20
I'M ROCKING....21
VALLE DHIMBJEJE....22
DANCE OF PAIN....23
ËNDËRR....24
DREAM....25
DALLËNDYSHE....26
SWALLOW....27
VERËS SË VERDHË....28
YELLOW SUMMER....30
DASMË VERE....32
SUMMER WEDDING....33

BREGUT TË DETIT....34
BY THE SEA COAST....35
MAGJI VERE....36
SUMMER SPELL....37
RINJOHJE....38
RENEWED ACQUAINTANCE....39
ENGJËLLIT....40
TO AN ANGEL....42
JETË E ERËZUAR....44
SPICY LIFE....46
GURIT....48
TO THE STONE....49
PLAGË DETI....50
SEA WOUND....51
DASMË E FTOHTË....52
COLD WEDDING....53
IMAZH....54
IMAGE....55
MALL DIMRI....56
WINTER LONGING....57
MIKES SIME....58
TO MY OLD FLAME....59
PRANVERËS....60
TO THE SPRING....62

LIQENIT 64
TO THE LAKE 65
MAGJI 66
SUMMER SPELL 67
NDRYSHE 68
DIFFERENTLY 69
TY 70
YOU 71
TË LUTEM EJA 72
PLEASE COME 73
KËNGË VJESHTE 74
AUTUMN SONG 75
TINGUJT E SHIUT 76
SOUNDS OF RAIN 77
LUMIT 78
TO THE RIVER 79
MAKTH NATE 80
NIGHTMARE 81
RESHJE BORE 82
SNOWFALL 83
PO VDES 84
I AM DYING 85
VALLE VARRESH 86
GRAVE DANCE 87

SOMNABUL 88
SOMNAMBULIST 89
ELEGJI VJESHTE 90
AUTUMN ELEGY 91
LUTJE 92
PRAYER 94
DASHURI DETI 96
SEA LOVE 97
MURGESHË KRESHTASH 98
NUN OF THE RIDGES 99
ECJE E PLAKUR 100
OLD WALK 101
GURINËS 102
STONY GROUND 103
GJURMËVE TË DHIMBJES 104
AFTER THE TRACES OF PAIN 105
VAJ MURGU 106
MONK'S CRY 108
ITINERAR I CAKTUAR 110
DESIGNATED ROUTE 111
YLLIT 112
STAR 113
ENGJËLLIT TË FJETUR 114
TO THE SLEEPING ANGEL 115

AG MËNGJESI....116
MORNING DAWN....117
MUZA IME....118
MY MUSE....119
NË STACION TRENI....120
AT THE TRAIN STATION....121
MONOLOG....122
MONOLOGUE....123
NOSTALGJI....124
NOSTALGIA....125
NET MALLI....126
NIGHTS OF LONGING....128
EKSTAZË PËRVËLUESE....130
BURNING ECSTASY....131
SHTEGTAR I VONUAR....132
LATE MIGRANT....133
VETMI....134
SOLITUDE....135
HIMNI I TMERRIT....136
ANTHEM OF HORROR....137
ZJARR....138
FIRE....139

KLUBI LETRAR
"DE RADA" FERIZAJ

Arben Ademi
NËPËR STINË
Poezi
THROUGH THE SEASONS
Poems
Translated by Fadil Bajraj

©Arben Ademi
©Klubi Letrar "De Rada"

Redaktorë:
Xhevdet Bajraj
Zyrafete Shala

Recensentë:
Arsim Hamiti
Gazmend Bytyçi

Kopertina:
Drian Shala
Jeta Rexhepi

Shtypi:
Shtypshkronja
InterGraf – Ferizaj

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Ademi, Arben
Nëpër stinë: poezi = Through the seasons: poems / Arben Ademi; translated by Fadil Bajraj - Ferizaj: Klubi Letrar "De Rada", 2022. - 146 f.; 20 cm.

Letërsia shqipe -- Poezi shqipe
1. Ademi, Arben

ISBN 978-9951-572-38-5

Aleph [000104561]